

MARRËVESHJE MOBILITETI

Albanian Skills NAT. ASSOC. FOR SKILLS COMPET., me zyrë qendrore në Rruga “Stanislav Zuber”, ND 2, Hy. 19 , e përfaqësuar ligjërisht nga Ana Zacharian, lindur në Bures, më 26/07/1965 përcaktuar në vijim si “organizata dërguese”

dhe

Emri dhe Mbiemri i Studentit _____

Data e lindjes _____

Kombësia _____

Adresa _____

Tel/Cel _____

E-mail _____

ËSHTË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

NENI 1 – OBJEKTI

1.1 Projekti Intervet WB do t'i mundësojë mbështetje financiare Pjesëmarrësit për realizimin e një periudhe mobiliteti jashtë vendit.

1.2 Pjesëmarrësi e pranon ndihmën financiare të treguar në Nenin 3 dhe ndërmerr plotësimin e periudhës së mobilitetit, siç parashikohet në Kushtet e Përgjithshme, që formojnë një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.3 Çdo modifikim i kësaj kontrate kërkohet dhe autorizohet nga të dyja palët përmes një letre zyrtare ose e-mail.

NENI 2 – PERIUDHA E VLEFSHMËRISË SË KONTRATËS DHE KOHËZGJATJA E MOBILITETIT

2.1 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e palës së fundit kontraktuese.

2.2 Periudha e mobilitetit do të ketë një kohëzgjatje prej 88 ditësh (+ 2 udhëtime) dhe do të mbahet në një periudhë midis 01/09/2021 dhe 31/12/2021.

2.3 Pjesëmarrësi merr mbështetje financiare për një periudhe prej 90 ditësh.

2.4 Certifikata/Certifikata e Trajnimit lëshuar nga organizata pritëse duhet të sigurojë dhe konfirmojë datat e fillimit dhe përfundimit të periudhës së mobilitetit.

NENI 3 – MBËSHËTETJA FINANCIARE

3.1 Projekti Intervet WB siguron një kontribut për mbulimin e kostove të akomodimit, udhëtimit, transportit lokal dhe një kontribut për ushqimin, brenda limiteve të vendosura nga projekti. Organizata dërguese duhet të sigurojë që standartet e nevojshme të cilësisë dhe sigurisë janë përmbushur në sigurimin e kësaj mbështetjeje. Kontributi i lartëpërmendur do të mbulohet drejtpërdrejtë nga partneri pritës dhe dërgues.

3.2 Ndjekja e programit të trajnimit jashtë vendit është e detyrueshme, përveç rasteve kur shkakton probleme shëndetësore të vërtetuara siç duhet nga një mjek.

3.3 Mbështetja financiare ose pjesë e saj duhet të kthehet tek organizata dërguese në rast se Pjesëmarrësi nuk respekton dispozitat e kësaj kontrate. Nëse Pjesëmarrësi ndërpret periudhën e mobilitetit përpara afatit, ai/ajo duhet të rimbursojë shumën e kontributit tashmë të paguar dhe rezultati nuk mund të raportohet. Nëse Pjesëmarrësi nuk e ka përmbushur aktivitetin e mobilitetit për shkak të forcës madhore, të tilla raste duhen raportuar tek organizata dërguese dhe të pranohen nga ajo. Në rast mospranimi nga Komisioni Evropian, kthimi i shumës tek Aplikanti do të bëhet në çdo rast nga Pjesëmarrësi.

NENI 4 – SIGURIMI

4.1 Pjesëmarrësi duhet të mbrohet nga mbulimi i përshtatshëm i sigurimit.

4.2 Për qëllime të mbulimit të sigurimit të shëndetit kundrejt problemeve shëndetësore, është përcaktuar një sigurim i dedikuar. Numri i sigurimit do të komunikohet përpara nisjes.

4.3 Për qëllime të mbulimit të sigurimit për përgjegjësinë civile, i cili mbulon çdo dëm të shkaktuar në punë nga Pjesëmarrësi, është përcaktuar një sigurim i dedikuar. Numri i sigurimit do të komunikohet përpara nisjes.

4.4 Për qëllime të mbulimit të sigurimit kundrejt aksidenteve të ardhura prej detyrave të Anëtarit në punë, është përcaktuar një sigurim i dedikuar. Numri i sigurimit do të komunikohet përpara nisjes, kostot e shëndetit janë të përjashtuara nga fushëveprimi i mbulimit të sigurimit lidhur me menaxhimin e sëmundjes. Për shembull, riatdhësi, operacioni, trajtimi dentar nuk janë të mbuluara nga sigurimi por do të trajtohen sipas Nenit 4.2.

NENI 5 – INVESTIGIMI I PROJEKTIT

6.1 Pjesëmarrësi duhet të plotësojë dhe dërgojë një intervistë online në përfundim të periudhës së mobilitetit dhe në çdo rast brenda tridhjetë ditëve kalendarike që nga marrja e ftesës nga

organizata dërguese për plotësimin e pyetësorit përkatës. Pjesëmarrësve të cilët nuk e kanë plotësuar dhe dërguar pyetësorin online, organizata dërguese ka të drejtën tu kërkojë rimbursim të plotë ose të pjesshëm të mbështetjes financiare të marrë dhe një rezultat jo të përgjegjshëm.

NENI 7 – LIGJI I ZBATUESHËM DHE GJYKATA KOMPETENTE

7.1 Kontrata rregullohet nga dispozita të përcaktuara nga Legjislacioni Kombëtar mbi grantet.

7.2 Gjykata kompetente, në përputhje me legjislacionin kombëtar, ka të drejtë të rregullojë çdo mosmarrëveshje midis organizatës dërguese dhe Pjesëmarrësit për sa i përket aplikimit, interpretimit dhe vlefshmërisë së dispozitave të kësaj kontrate, në rast se të tilla mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Neni 1: Përgjegjësia

Secila palë kontraktuese përjashton tjetrën nga çdo përgjegjësi civile për dëme të pësuar nga ai ose stafi i tij si rezultat i zbatimit të kësaj kontrate, me kusht që dëmet të mos jenë rezultat i shkeljes serioze apo të qëllimshme.

Pjesëmarrësi deklaron se është informuar mbi modalitetet korrekte të sjelljes gjatë eksperiencës jashtë vendit, ashtu si u prezantuan gjatë trajnimit para-shkollor.

Komisioni Evropian dhe stafi i tij nuk do të mbajnë përgjegjësi në rast ankesash lidhur me dëme të shkaktuara gjatë realizimit të mobilitetit. Rrjedhimisht, Komisioni Evropian nuk do të marrë në konsideratë asnjë ankesë për dëme nga secila prej palëve kontraktuese.

Neni 2: Tërheqja dhe përfundimi i kontratës

Në rast të shkeljes së kontratës nga Pjesëmarrësi, pa konsideruar pasojat që vijnë nga zbatimi i legjislacionit, organizata dërguese është ligjërish e autorizuar për përfundimin e kontratës pa formalitete të mëtejshme nëse pjesëmarrësi nuk ndërmer asnjë veprim brenda një muaji nga marrja e letrës së regjistruar.

Nëse pjesëmarrësi tërhiqet para kohe nga kontrata për arsye që nuk i atribuohen forcave madhore ose në rast se ai nuk respekton me dispozitat e kontratës, ai duhet të ripaguajë shumën e huasë tashmë të paguar.

Përkundrazi, në rast të përfundimit të kontratës nga Pjesëmarrësi për shkak të forcave madhore, (një situatë e paparashikueshme dhe përjashtimore përtej kontrollit të tij dhe që nuk i atribuohet gabimit ose neglizhencës), ky i fundit do të marrë shumën e huasë së llogaritur në proporcion me kohëzgjatjen e kontratës. Qëndrimi i tij jashtë vendit, bazuar në atë që përcaktohet në Nenin 2.2. Çdo shumë e mbetur duhet kthyer, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe me organizatën dërguese.

Neni 3: Përpunimi i të dhënave

Të dhënat personale të përfshira në kontratë do të përpunohen në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga organet e Komunitetit dhe transferimin e lirë të të dhënave. Të dhënat do të zbulohen vetëm për aktivitetet që lidhen me implementimin dhe ndjekjen e kontratës nga organi dërgues, Agjencia Kombëtare dhe Komisioni Evropian, pa cënuar mundësinë e kalimit të të dhënave te organet përgjegjëse për inspektime dhe auditime në përputhje me legjislacionin e Komunitetit (Gjykata e Audituesve ose Zyra Evropiane Anti-Mashtrim).

Pjesëmarrësi mund që, përmes kërkesës së shkuar, të ketë akses në të dhënat e tij personale dhe të procedojë me korrigjimin e informacioneve të gabuara ose të paplota. Pjesëmarrësi mund të kërkojë çdo lloj informacioni lidhur me përpunimin e të dhënave të tij personale. Pjesëmarrësi mund të depozitojë një ankesë me Garantuesin për mbrojtjen e të dhënave sensitive duke vepruar konform me Dekretin Legjislativ n. 196/2003, lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja nga agjencia dërguese dhe/ose nga Agjencia Kombëtare ose Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave në lidhje me përdorimin e të dhënave nga Komisioni Evropian.

Neni 4: Kontrollat dhe Auditimet

Palët Kontraktuese marrin përsipër të sigurojnë të gjithë informacionin e kërkuar nga Komisioni Evropian ose çdo organ tjetër i autorizuar prej tyre me qëllim verifikimin e performancës së mirë të periudhës së mobilitetit në përputhje me dispozitat e kontratës.

Pjesëmarrësi është gjithashtu i gatshëm të marrë pjesë në veprimet e monitorimit dhe vlerësimit nga Komisioni Evropian në 24 muajt e ardhshëm pas datës së mbylljes së aktiviteteve të projektit dhe, brenda limiteve të mundësive të tij, t'i komunikojë organit çdo ndryshim të mundshëm të rezidencës së tij.

Për Pjesëmarrësin:

Emri dhe Mbiemri

Firma

Emri dhe Mbiemri i prindit / kujdestarit ligjor

Firma e prindit / kujdestarit ligjor

Vendi dhe Data.....

Një kopje e fotokopjes nga të dyja anët të kartës së identitetit të prindit / kujdestarit ligjor të pjesëmarrësit është bashkëngitur.

Për organizatën dërguese:

Emri dhe Mbiemri i Përfaqësuesit Ligjor

Firma

Vendi dhe Data.....